

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 22, datë 19.06.2019


**Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të automjetit tip “Volkswagen Passat”,  
me numër shasie WVWZZZ3BZ4P158011, me targë AA 469 AP,  
nëpërmjet procedurës së shitjes me ankand tërësor”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “f”, të nenit 53, pika 6 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 20, pika 4, të nenit 22, pika 2, shkronja “c” dhe pika 3 shkronja “b”, nënndarja “i”, si dhe të nenit 23, pika 1, shkronja “c” të Rregullores nr. 5, datë 30.03.2017 “Për administrimin e aktiveve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr.48, datë 5.06.2019 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale “Automjete”, për nxjerrjen jashtë përdorimit në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të nenit 18 të Rregullores nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

---

V E N D O S I:

1. Miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të automjetit tip “Volkswagen Passat”, me numër shasie WVWZZZ3BZ4P158011, me targë AA 469 AP, nëpërmjet procedurës së shitjes me ankand tërësor.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe informimin e Këshillit Drejtues mbi zbatimin e tij.



## KËSHILLI DREJTUES

3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**